



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 179 prot.

Kamëz, më _____ 2020

V E N D I M

Nr. 153 Datë 18.12.2020

MBI

Dhënien e ndihmës financiare prej 100 000 (njëqind mijë) lekë për familjet e Z.Vangjel Nuri RRIÇKU, banues në Paskuqan 2, Rr "Padil Rifati", Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz si dhe familjen e Zj. Lucie Mark Haklaj banuese në Frutikulturë, Rr "Liria" Lagjia Administrative Nr 2 Kamëz të cilëve u është djegur banesa.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 18.12.2020 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.143 Datë 14.12.2020** Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji, Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe V.K.B Kamez Nr. 60, datë 23.12.2019 "Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr: 03280, Art. 606: si dhe relacionit të drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak Kamëz :

V E N D O S I :

1. Dhënien e ndihmës financiare prej 100 000 (njëqind mijë) lekë për dy familjet të cilëve ju është djegur banesa përkatësisht:
 - 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për familjen e Z.Vangjel Nuri Rriçku
 - 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për familjen e Zj. Lucie Mark Haklaj
2. Shuma prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh që do përdoret për ndihmë financiare për familjet e sipërpërmendura do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: **Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606.**
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

